

Zhvillimet e fundit në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për lirinë e shprehjes



Liria e shprehjes dhe liria e medias

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

<https://www.coe.int/en/web/freedom-expression>

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

Buletini Nr. 5

Zhvillimet më të fundit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me Lirinë e Shprehjes

Autor: Peter Noorlander.

Ky buletin u përgatit në kuadër të Programit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022", dhe projektit të tij mbi "Lirinë e Shprehjes dhe të Medias në Evropën Juglindore (JUFREX)".

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon "©Këshilli i Evropës, 2022". Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Të gjitha korrespondencat e tjera në lidhje me këtë publikim duhet t'i drejtohen Divizionit për bashkëpunim për Lirinë e Shprehjes, Departamenti i Shoqërisë së Informacionit, DG1, Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimi i Ligjit, Këshilli i Evropës, Avenue de l'Europe F-67075 Strasbourg Cedex, France, Tel. +33 (0)3 88 41 20 00
E-mail: Horizontal.Facility@coe.int.

© Këshilli i Evropës, dhjetor 2022.
Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Europian sipas kushteve të miratuara.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu janë përgjegjësi e autorit dhe nuk mund të merren në asnjë mënyrë si pasqyrim i mendimit zyrtar të asnjërës palë.

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
ANALIZË E ÇËSHTJEVE MË TË RËNDËSISHME TË LIDHURA ME LIRINË E SHPREHJES	7
<i>Šeks kundër Kroacisë, vendim, datë 3 shkurt 2022, ankimi nr. 39325/20</i>	7
<i>Mediengruppe Österreich GmbH. kundër Austrisë, vendim, datë 26 prill 2022, ankimi nr. 37713/18</i>	8
<i>Mesić kundër Kroacisë, vendim, datë 5 maj 2022, ankimi nr. 19362/18</i>	10
<i>Oganezova kundër Armenisë, vendim, datë 17 maj 2021, ankimi nr. 71367/12</i>	12
<i>Żurek kundër Polonisë, vendim, datë 16 qershor 2022, ankimi nr. 39650/18</i>	13
<i>Drousiotis kundër Qipros, vendim, datë 5 korrik 2022, ankimi nr. 42315/15</i>	15
<i>Tagiyeva kundër Azerbajxhanit, vendim, datë 7 korrik 2022, Ankimi nr. 72611/14</i>	17
ANALIZË E THELLUAR E ÇËSHTJEVE TË PËRZGJEDHURA	19
<i>OOO Memo kundër Rosisë, vendim, datë 15 mars 2022, ankimi nr. 2840/10</i>	19
<i>NIT S.R.L. kundër Moldavisë, vendim, datë 5 prill 2022, ankimi nr. 28470/12</i>	21

Hyrje

Ky buletin përgatitet në kuadër të iniciativës së përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022” dhe projektit të tij me temë **“Liria e shprehjes dhe e mediave në Evropën Juglindore (JUFREX).”**

Për të vazhduar bashkëpunimin me profesionistët ligjorë, certifikimin e trajnerëve nga JUFREX dhe kontributin për përmirësimin e mëtejshëm të njohurive në fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, kemi përgatitur këtë buletin si një tjetër mjet që shërben për shkëmbimin e informacionit mbi tendencat dhe zhvillimet e reja në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ, Gjykata).

Ndërsa Buletini Nr. 1 mbulonte periudhën prill 2019–korrik 2020, Buletini Nr. 2 periudhën gusht 2020–janar 2021, Buletini Nr. 3, mbulonte periudhën shkurt 2021–korrik 2021, Buletini Nr. 4, përfshin disa nga vendimet relevante të shpallura nga korrik 2021 - janar 2022. Buletini Nr 5, para jush prezanton disa nga ato përkatëse aktgjykimet e dhëna në periudhën shkurt-korrik 2022.

Gjatë periudhës shkurt 2022 – korrik 2022, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë Gjykata, ose GJEDNJ) dha 39 vendime themeli dhe 14 vendime pranueshmërie për çështje që lidhen me të drejtën e lirisë së shprehjes.¹ Çështjet mbulonin një sërë aspektesh, duke filluar nga rregullimi i transmetimit, deri te siguria e gazetarëve.

Pjesa më e madhe e çështjeve mbështeteshin tek Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më poshtë Konventa, ose KEDNJ-ja), i cili mbron të drejtën për lirinë së shprehjes, por në disa çështje kërkuesit e bazuan kërkesën e tyre në dispozita të ndryshme, duke ilustruar mbivendosjen ose ndërveprimin ndërmjet lirisë së shprehjes dhe të drejtave të tjera. Pesë çështje kishin të bënin me Nenin 8, i cili mbron të drejtën për respektimin e jetës private (i përdorur si bazë nga kërkuesit për t’u ankuar për shpifje ose ndërhyrje në privatësi nga media); tri çështje u bazuan në Nenin 11, i cili mbron të drejtën për lirinë e tubimit (këto çështje kishin të bënin kryesisht me të drejtat e shprehjes së protestuesve); një çështje u vendos në bazë të Nenit 9, i cili mbron të drejtën për lirinë së fesë (çështja kishte të bënte me të drejtën e shprehjes fetare). Një çështje që kishte të bënte me sigurinë e gazetarëve u vendos në bazë të Nenit 2, i cili mbron të drejtën për jetën, ndërsa një çështje që kishte të bënte me gjuhën e urrejtjes u vendos në bazë të Nenit 3, i cili mbron të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore ose shtëruese.

I pari nga dy gjykimet kryesore të zgjedhura për analizë të thelluar në këtë Buletin, [OOO Memo kundër Rusisë](#), ka të bëjë me çështjen nëse një organ publik duhet të lejohet ose jo të padisë për shpifje një

1 Sipas sistemit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, çështjet duhet të kalojnë një fazë të pranueshmërisë. Ndonjëherë, kjo çon në një vendim të veçantë të gjykatës nëse një çështje është depozituar në kohë, është haptazi e pabazuar (që do të thotë se nuk ka asnjë bazë për çështjen), ose nëse ajo duhet të përjashtohet për arsye të tjera (si, për shembull, çështjet e gjuhës së urrejtjes mund të përjashtohen si “shpërdorim i të drejtave” sipas nenit 17 të Konventës). Përveç gjyqimeve dhe vendimeve mbi pranueshmërinë, edhe 19 çështje të tjera u “eliminuan”, për shkak të arritjes së një marrëveshje miqësore ose sepse kërkuesi kishte ndërprerë komunikimin me gjykatën.

media që është kritike ndaj tij. Në vendimin e saj, Gjykata merret me pyetjen nëse mbrojtja e reputacionit të organeve publike përbën një qëllim legjitim në bazë të të cilit mund të kufizohet e drejta për lirinë e shprehjes dhe prek aspektet e të ashtuquajturave çështje SLAPP (akronimi për paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike). Në çështjen e dytë që është analizuar në thellësi, [NIT kundër Moldovisë](#), Gjykata trajton aspektin e rëndësishëm nëse mund të tërhiqet licenca e një transmetuesi që ka shkelur në mënyrë të përsëritur kërkesën për paanshmëri politike dhe, nëse po, çfarë lloj garancish procedurale janë të nevojshme.

Ky buletin gjithashtu përmbledh gjashtë çështje të tjera që mbulojnë aspekte të ndryshme, të tilla si: aksesit në informacion, e ashtuquajtura “e drejta për t’u harruar”, e cila është një fushë në zhvillim e jurisprudencës së Gjykatës, shpifja e kryer nga Presidenti i një vendi, mbrojtja nga gjuha e urrejtjes, liria e shprehjes së gjyqtarëve dhe e drejta e tyre për të komentuar çështjet me interes publik, proporcionaliteti i dëmeve në rastet e shpifjes, dhe siguria e gazetarëve.

Në 21 nga 29 vendimet e mbështetura në Nenin 10 dhe në tre nga katër vendimet e mbështetura në Nenin 8, Gjykata konstatoi shkelje të Konventës. Gjykata gjithashtu konstatoi shkelje në çështjet e mbështetura në Nenin 2 dhe Nenin 3, në lidhje me të drejtën për jetë dhe të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore ose poshtëruese. Çështja e fundit ka të bëjë me mbrojtjen kundër gjuhës së urrejtjes dhe thekson rëndësinë e detyrës së shteteve për të ndërmarrë hapa efektivë për të mbrojtur njerëzit nga gjuha e urrejtjes për çfarëdo shkak, përfshirë orientimin seksual, ndërkohë që mbron gjithashtu të drejtën për lirinë e shprehjes. Shkalla e vazhdueshme e lartë e shkeljeve në çështjet e theme-lit tregon se praktikat kombëtare në shumë fusha të së drejtës janë ende shpesh jo në përputhje me kërkesat e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Dhoma e Madhe e Gjykatës, e cila mund të shqyrtojë çështje që ngrenë aspekte serioze në lidhje me interpretimin e Konventës, refuzoi një kërkesë për referim në çështjen *Vedat Şorli kundër Turqisë*, diskutuar në Buletinin Nr. 4, për të cilën Seksioni i Dytë i Gjykatës kishte vendosur se shteti i paditur duhet të shfuqizojë dispozitën e legjislacionit penal që i jep mbrojtje të veçantë reputacionit të kreut të shtetit. Kjo do të thotë se vendimi i Seksionit të Dytë për këtë çështje tani është i formës së prerë. Gjatë periudhës shkurt-korrik, Dhoma e Madhe mbajti seanca dëgjimore për disa çështje të tjera të lidhura me lirinë e shprehjes:

- [Hurbain kundër Belgjikës](#) (vendim, datë 22 qershor 2021, ankimi nr. 57292/16; referimi u pranua më [11 tetor 2021](#)), e cila lidhet me të ashtuquajturën “e drejta për t’u harruar”;
- [Sanchez kundër Francës](#) (vendim, datë 2 shtator 2021, ankimi nr. 45581/15; referimi u pranua më [17 janar 2022](#)), e cila lidhet me masën në të cilën një politikan mund të deklarohet përgjegjës për përmbajtjen e postuar nga të tjerët në faqen e tyre në Facebook;
- [Macatė kundër Lituanisë](#) (ankimi nr. 61435/19, dorëzuar në Dhomën e Madhe më [31 gusht 2021](#)), e cila lidhet me ankesën e një autoreje e cila pretendon se libri i saj për fëmijë që përmban përralla për LGBTQI-të është etiketuar se mund të jetë i dëmshëm për fëmijët; dhe
- [Halet k. Luksemburgut](#) (vendim, datë 11 maj 2021, ankimi nr. 21884/18, referimi u pranua më [21 shtator 2021](#)), i cili lidhet me dënimin penal të një sinjalizuesi të drejtësisë.

Kjo do të thotë se aktualisht, së bashku me ndryshimet klimatike dhe një sërë çështjesh në lidhje me luftën në Ukrainë, e drejta për lirinë e shprehjes është një nga kategoritë kryesore të çështjeve para Dhomës së Madhe.

Analizë e çështjeve më të rëndësishme të lidhura me lirinë e shprehjes

Šeks kundër Kroacisë, vendim, datë 3 shkurt 2022, ankimi nr. 39325/20

Faktet e çështjes

Kërkuesi, një politikan në pension i cili kishte mbajtur disa funksione të larta politike, duke përfshirë atë të zëvendëskryeminitrit, paraqiti një kërkesë në Arkivin e Shtetit të Kroacisë për akses në një koleksion dokumentesh që përbënin pjesë të arkivit presidencial. Ai deklaroi se kërkonte akses në të dhënat në lidhje me një libër që po shkruante që kishte të bënte me themelimin e shtetit të Kroacisë. Dokumentet ishin klasifikuar si “sekret shtetëror – rreptësisht konfidenciale” dhe Arkivi i Shtetit i kërkoi Zyrës së Presidentit që të vendosë lidhur me kërkesën. Nga ana tjetër, Zyra e Presidentit kërkoi mendimin e Zyrës së Këshillit të Sigurisë Kombëtare, e cila këshilloi se zbulimi i disa prej dokumenteve do të shkaktonte dëmtim të pavarësisë, integritetit dhe sigurisë kombëtare të Republikës së Kroacisë dhe marrëdhënieve të saj me jashtë. Në vijim, Zyra e Presidentit deklasifikoi tridhjetë e një nga dokumentet e kërkuara, por nuk pranoi të deklasifikonte njëzet e pesë dokumentet e mbetura, përfshirë edhe transkriptet nga seanca të caktuara të Këshillit të Mbrojtjes dhe Sigurisë Kombëtare, si dhe të dhëna të caktuara të takimeve midis Presidentit të atëhershëm të Kroacisë dhe zyrtarëve të lartë të huaj. Kërkuesi depozitoi një ankim pranë Komisionerit për Informacionin. Komisioneri i kontrolloi vetë dokumentet dhe më pas pushoi ankimin. Ankimet e mëtejshme gjyqësore, duke përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese, ishin të pasuksesshme.

Kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjkata fillimisht shqyrtoi nëse kërkesa binte brenda fushës së veprimit të Nenit 10. Ajo përsëriti se Neni 10 nuk i jep individit të drejtën e aksesit në informacionin e mbajtur nga një autoritet publik ose nuk e detyron qeverinë të japë një informacion të tillë, por që një e drejtë ose detyrim i tillë mund të lindë kur aksesit në informacion është i domosdoshëm për ushtrimin e të drejtës së individit për lirinë e shprehjes (shih [Magyar Helsinki Bizottság kundër Hungarisë \[GC\]](#), ankimi nr. 18030/11, datë 8 nëntor 2016, para. 156). Kriteret kryesore për ta përcaktuar këtë janë: (a) qëllimi i kërkesës për informacion; (b) natyra e informacionit të kërkuar; (c) roli i kërkuesit; dhe (d) nëse informacioni është i gatshëm dhe i disponueshëm. Gjykata konstatoi se plotësoheshin të gjitha këto kritere: kërkuesi kërkoi akses në dokumentet e klasifikuara në mënyrë që të përdorte informacionin e marrë për qëllim të shkrimit të një libri; natyra e informacionit lidhej me çështje të interesit publik; kërkuesi ishte studiues dhe autor i literaturës për një çështje me interes publik; dhe të dhënat e kërkuara ishin të gatshme dhe të disponueshme. Kjo do të thoshte se kërkesa binte në fushën e veprimit të Nenit 10.

Gjykata gjithashtu hodhi poshtë kundërshtimin paraprak të qeverisë sipas nenit 35, para. 3(b) të Konventës, se kërkuesi nuk kishte pësuar një disavantazh të konsiderueshëm, sepse ajo i kishte zbuluar tridhjetë e një nga pesëdhjetë e gjashtë

dokumente të klasifikuara dhe se kërkuesi kishte qenë në gjendje të shkruante librin e tij. Gjykata mori parasysh deklaratën e kërkuesit se mohimi i aksesit kishte shkaktuar vonesë dhe i kishte kërkuar atij të kryente kërkime të mëtejshme; si dhe se kërkuesi e konsideronte punën e tij të botuar si të paplotë dhe kishte vendosur ta përditësonte atë nëse do t'i jepej ndonjëherë akses në dokumentet e klasifikuara. Për më tepër, Gjykata vlerësoi se çështja kishte ngritur pikëpyetje të rëndësishme parimore dhe nuk duhet të hidhej poshtë me arsyetimin e pretenduar se kërkuesi nuk kishte pësuar ndonjë disavantazh të madh.

Duke iu kthyer themelit të çështjes, Gjykata vuri në dukje se kërkesa kishte të bënte me informacion të klasifikuar në lidhje me një pjesë të ndjeshme të historisë së fundit të Kroacisë. Gjykata vuri në dukje se siguria kombëtare ishte një koncept në zhvillim, e varur nga konteksti, dhe se shteteve duhet t'u jepet një prag i gjerë vlerësimi në përcaktimin e asaj që përbën rrezik për sigurinë kombëtare në vendet e tyre në një kohë të caktuar. Gjithashtu, Gjykata theksoi se konceptet e "sigurisë kombëtare" dhe "sigurisë publike" duhet të zbatohen me kufizim, të interpretohen në mënyrë kufizuese dhe të përdoren vetëm atëherë kur dëshmohet se përdorimi i tyre është vërtet i nevojshëm. Gjykata gjithashtu vuri në dukje se konceptet e ligjshmërisë dhe shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike janë vendimtare për të zgjidhur çështje të tilla, dhe se drejtësia e proceseve dhe garancitë procedurale që i jepen kërkuesit janë faktorë që duhen marrë parasysh.

Gjykata vërejti se asgjë në dosjen e çështjes nuk sugjeronte se autoritetet kompetente nuk kishin kryer një analizë të proporcionalitetit. Kërkesa e kërkuesit ishte vlerësuar me kujdes nga pesë autoritete të ndryshme kombëtare; dokumentet e kërkuara u kontrolluan drejtpërdrejt nga të paktën dy prej tyre. Gjykata vuri në dukje më tej se vendimi i Presidentit për të refuzuar deklasifikimin e disa prej dokumenteve të kërkuara bazohej në opinionin e një organi të specializuar për trajtimin e çështjeve të sigurisë kombëtare dhe përfundimisht u shqyrtua dhe u la në fuqi nga Komisioneri për Informacionin, Gjykata e Lartë Administrative dhe Gjykata Kushtetuese. Kjo ishte në përputhje me masat mbrojtëse procedurale. Ndërsa Gjykata pranoi se autoritetet kombëtare nuk kishin dhënë

arsye të hollësishme për refuzimin e aksesit në dokumente, Gjykata u shpreh se kjo ishte e kuptueshme pasi dhënia e arsyeve të hollësishme mund të zbulonte aspektet e sigurisë kombëtare në fjalë. Gjykata arriti në përfundimin se e drejta e kërkuesit për lirinë e shprehjes nuk ishte shkelur.

Shënim: Praktika gjyqësore e Gjykatës është tashmë e konsoliduar sa i takon të drejtës për lirinë e shprehjes, e cila përfshin të drejtën e aksesit në informacionin e mbajtur nga organet publike kur kjo është e nevojshme për ushtrimin e lirisë së shprehjes. Një studiues që shkruan një libër, një gazetar që shkruan një artikull, ose një OJQ që bën kërkime për një raport, të gjithë mund të mbështeten në Nenin 10 të Konventës për të kërkuar akses në informacion kur çështja lidhet me një temë me interes publik dhe informacioni në fjalë është i disponueshëm në mënyrë të arsyeshme. Ajo që nënvizon ky gjykim është se kur informacioni nuk jepet në mënyrë legjitime, për shembull për shkak se botimi i informacionit do të shkaktonte dëm për sigurinë kombëtare, dhënia e arsyeve të hollësishme për refuzimin mund të jetë e vështirë. Kur kjo ndodh, masat mbrojtëse procedurale marrin një rëndësi të veçantë. Në çështjen objekt analize u kërkua mendimi i organeve të specializuara dhe në apel, vetë Komisioneri për Informacionin inspektoi dokumentet dhe ra dakord që ato nuk mund të bëheshin publike. Ndërkohë që në mendjen e kërkuesit ndoshta do të vazhdojë të ketë një dyshim se "ata po fshehin diçka", në fund të fundit në një demokraci të qeverisur nga shteti i së drejtës, publiku duhet të jetë në gjendje të besojë në këto masa mbrojtëse procedurale, me kusht që sigurisht ato të jenë të pavarura dhe të paanshme. Gjykata nuk gjeti asnjë të metë në qasjen e autoriteteve kombëtare.

Mediengruppe Österreich GmbH.
kundër Austrisë, vendim, datë 26 prill
2022, ankimi nr. 37713/18

Faktet e çështjes ■■■

Kërkuesi, pronar i një gazete të përditshme, botoi një raport mbi një takim të zhvilluar midis një kandidati në zgjedhjet kombëta-

re presidenciale dhe gazetës së përditshme gjermane, *Bild*. Artikulli raportonte se gjatë takimit, kandidatit i ishte treguar një fotografi e vitit 1987 ku shfaqej menaxheri i zyrës së kandidatit dhe vëllai i tij në një grumbullim të "krahut të djathtë". Artikulli i referohej vëllait të menaxherit të zyrës si një "neonazist i dënuar". Artikulli raportonte se menaxheri i zyrës ishte nën 18 vjeç në kohën e fotografimit, se ai nuk ishte dënuar apo raportuar në polici dhe se ai perceptohej si "Mitläufer" ('ndjekës') i krahut të djathtë të asaj kohe. Vëllai i menaxherit të zyrës ngriti padi kundër gazetës, ku kërkonte një urdhër gjyqësor kundër botimit të fotografive pa pëlqimin e tij dhe kundërshtonte cilësimin e tij si neonazist i dënuar ose terma me kuptim të ngjashëm. Ai argumentoi se megjithëse ishte dënuar në vitin 1995, ai ishte liruar me kusht në vitin 1999 dhe se që atëherë ishte riintegruar në shoqëri, kishte krijuar një familje dhe kishte një punë të rregullt. Çështja e tij u pushua nga gjykatat më të ulëta, por Gjykata e Lartë u shpreh në favor të tij, duke e ndaluar gazetën të "botojë fotografi ... pa pëlqimin e tij, nëse në të njëjtën kohë ai etiketohet si neonazist i dënuar në raportin shoqëruar, dhe/ose shoqërohet me deklarata me kuptime ekuivalente për të."

Kërkuesit u ankuan në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjkata filloi duke ritheksuar parimet e përgjithshme të zbatueshme në çështje të tilla si kjo. Duhet të arrihet një ekuilibër midis të drejtës së kompanisë kërkuese për lirinë e shprehjes dhe lirisë së informimit të publikut nga njëra anë, dhe, të drejtës së individit për respektimin e jetës private dhe mbrojtjen e imazhit të dikujt nga ana tjetër. Sikurse përcaktohet në praktikën gjyqësore të Gjykatës, kriteret që duhen zbatuar për të arritur këtë ekuilibër përfshijnë: nëse artikulli kontribuon për një debat me interes publik; niveli i famës së personit në fjalë; tema e artikullit të lajmeve; sjellja e mëparshme të personit në fjalë; përmbajtja, forma dhe pasojat e botimit; dhe, kur është e përshtatshme, rrethanat në të cilat janë bërë fo-

tografitë (shih, ndër të tjera, [Von Hannover \(nr. 2\) kundër Gjermanisë](#), ankimi nr. 40660/08 60641/08, 7 shkurt 2012, para. 108–113; dhe [Axel Springer AG kundër Gjermanisë](#), ankimi nr. 39954/08, 7 shkurt 2012, para. 89–95). Për kërkesat e bazuara në Nenin 10, Gjykata shqyrton gjithashtu mënyrën se si është marrë informacioni dhe vërtetësinë e tij, si dhe peshën e dënimit të vendosur (shih [Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës](#), ankimi nr. 40454/07, 10 nëntor 2015, para. 93). Gjykata theksoi gjithashtu se kur autoritetet kombëtare kryejnë ushtrimin për gjetjen e ekuilibrit midis të drejtave konkurruese, në përputhje me kriteret e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës, do të nevojiteshin arsye të forta për të zëvendësuar pikëpamjen e Gjykatës me atë të gjykatave kombëtare.

Duke i zbatuar këto kritere në çështjen nën shqyrtim, Gjykata së pari konstatoi se përmbajtja e përgjithshme e artikullit ishte me interes të veçantë të publikut në kohën e botimit të tij. Megjithatë, Gjykata vuri në dukje se nuk kishte asnjë lidhje të drejtpërdrejtë midis kandidatit për President dhe vëllait të menaxherit të zyrës së tij, përveç se menaxheri i zyrës kishte marrë pjesë në një ngjarje neonaziste në vitin 1987. Gjykatat kombëtare e kishin shqyrtuar këtë aspekt deri në njëfarë pike dhe Gjykata Evropiane u shpreh se mund të pranonte përfundimin e tyre se botimi i fotografisë me një tekst jo të plotë shoqëruar nuk kontribuonte për debatin për zgjedhjet.

Gjykata e vijoi analizën duke vlerësuar se ndërsa vëllai i menaxherit të zyrës kishte padyshim një famë të keqe në kohën kur ishte dënuar, që atëherë kishin kaluar njëzet vjet dhe nuk kishte asnjë tregues se ai kishte qenë në qendër të vëmendjes që pas lirim të tij. Megjithëse Gjykata ra dakord që proceset gjyqësore kundër neonazistëve përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë gjyqësore në Austri, ajo u shpreh se nuk mund të arrihet automatikisht në përfundimin se "fama e keqe" e të pandehurve mbetet e pandryshuar gjatë viteve. Gjykata vuri në dukje se vëllai i menaxherit të zyrës ishte riintegruar në shoqëri pas lirim nga burgu dhe nuk kishte dënime të mëtejshme penale.

Duke iu kthyer mënyrës së marrjes së informacionit dhe vërtetësisë së tij, Gjykata u shpreh se kur botohet një foto e një të dënuari pas lirimimit nga burgu, teksti shoqërues duhet të jetë i plotë dhe i saktë. Gazeta i ishte referuar vëllait të menaxherit të zyrës si një neonazist i dënuar, por pa përmendur se dënimi ishte dhënë në vitin 1995 dhe se vëllai nuk ishte dënuar për një krim që atëherë. Kjo do të thotë se informacioni ishte i vërtetë, por i paplotë. Fakti që kishin kaluar njëzet vjet nga dënimi ishte një faktor i rëndësishëm, siç ishte fakti që dënimi ishte fshirë nga të dëshmia e tij penale. Gjykata theksoi se ekziston një interes i rëndësishëm shoqëror për riintegrimin në shoqëri të personave të cilët janë liruar nga burgu pas vuajtjes së dënimit dhe, për rrjedhojë, ekziston interesi i tyre legjitim që pas një periudhe të caktuar të mos ballafaqohen më me dënimin. Në fund, Gjykata vuri në dukje se ashpërsia e sanksionit të vendosur ishte e lehtë: nuk ishte dhënë asnjë dëmshpërblim dhe nuk ishte vendosur asnjë gjobë. Për këto arsye, dhe duke marrë parasysh pragun e vlerësimit që u jepet shteteve për vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjeve në lirinë e shprehjes, Gjykata u shpreh me shumicë votash (katër pro dhe tre kundër) se nuk kishte shkelje të së drejtës për liri të shprehjes.

Shënim: Ky ishte një gjykim ku katër gjyqtarë u shprehën po dhe tre jo, me një mendim pakice të fuqishëm nga gjyqtari Guerra Martins, të cilin iu bashkuan gjyqtarët Vehabović dhe Motoc, duke argumentuar se publiku ka të drejtë të dijë për të kaluarën neonaziste të dikujt që mund të jetë ende pranë një kandidati për President (ajo shkruan se “një zgjedhës me akses në të gjithë informacionin e duhur është më i vendosur dhe më i lirë për të zgjedhur midis dy ose më shumë kandidatëve sesa një zgjedhës që i mungon ky informacion»). Pas argumentit të saj qëndron një forcë e madhe morale, por gjykimi qëndron. Nga pikëpamja e jurisprudencës, ndoshta është më mirë të përqendrohemi te dallimi ndërmjet këtij vendimi dhe çështjes kyçe të “së drejtës për t’u harruar” [M.L. dhe W.W. kundër Gjermanisë](#) (ankimi nr. 60798/10 dhe 65599/10, 28 qershor 2018, raportuar në Buletinin nr. 4), ku përcaktohet se kur kriminelët e dënuar kërkojnë vëmendjen e medias, ata nuk mund të presin që e kaluara e tyre kriminale të “harrohet shpejt”. Në këtë rast,

përkundrazi, individi në fjalë ishte riintegruar në shoqëri, i ishte shmangur vëmendjes dhe dënimi ishte fshirë nga dëshmia e tij penale. Është në interes të shoqërisë që ata që kanë kryer një krim të mund të rehabilitohen.

Mesic kundër Kroacisë, vendim, datë 5 maj 2022, ankimi nr. 19362/18

Faktet e çështjes

Kërkuksi, i cili kishte qenë President i Republikës së Kroacisë nga viti 2000 deri në vitin 2010, ishte urdhëruar t’i paguante 6,600 euro dëmshpërblim një avokati për shpifje. Avokati, me qëndrim në Francë, kishte depozituar një kallëzim penal në gjykatat franceze kundër 11 shtetasve kroatë, përfshirë kërkuesin, në lidhje me dy akuza për tentativë për vrasje të një klienti të tij dhe një akuzë për tentativë për zhvatje. Midis të akuzuarve ishte edhe një individ i njohur në mediat kroate si bos i mafies. Media kroate raportoi mbi kallëzimin penal, duke e përshkruar kërkuesin si “një lloj mbrojtësi politik të personit që kishte urdhëruar vrasjen”. Mediat kontaktuan me avokatin, por ai tha se sipas ligjit francez, ai nuk ishte në gjendje të jepte asnjë hollësi rreth kallëzimit. Në një konferencë për shtyp, Presidenti mohoi të ishte i përfshirë në vrasje dhe tha se avokati që kishte bërë ankesën duhet të vizitohej një klinikë psikiatrike. Kjo deklaratë u botua në faqen zyrtare të Presidentit të Kroacisë si dhe në media. Avokati paditi Presidentin për shpifje. Gjykatat kroate konstatuan shkelje dhe vendosën në favor të avokatit, duke u shprehur se nderi dhe reputacioni i tij, si dhe besueshmëria e tij profesionale dhe morale, ishin dëmtuar dhe i dhanë atij shpërblim dëmi. Çështja në apel dështoi. Për rrjedhojë, kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata konstatoi, së pari, se qëllimi i kërkuesit nuk kishte qenë thjesht që të fyente avokatin: ai kishte dashur të mohonte

akuzat e rënda të bëra kundër tij dhe ishte përpjekur të jepte informacione ose ide. Për rrjedhojë, deklarata e tij binte brenda fushës së veprimit të mbrojtjes së lirisë së shprehjes sipas Nenit 10. Gjithashtu, Gjykata u shpreh se deklarata e bërë nga kërkuesi ishte mjaftueshëm e rëndë për të përbërë ndërhyrje në jetën private të avokatit, pasi ajo nxiste paragjykimet kundër tij si në fushën e tij profesionale, ashtu edhe në mjediset sociale.

Gjykata vijoi me shqyrtimin nëse vendimi për shpifje kundër tij mund të përbënte gjithsesi ndërhyrje legjitime në të drejtën e tij për lirinë e shprehjes, dhe në veçanti nëse ai ishte “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” dhe nëse balanconte në mënyrë të drejtë të drejtën e lirisë së shprehjes, nga njëra anë, dhe të drejtën për respektimin e jetës private, nga ana tjetër. Gjykata vuri në dukje se gjykatat kombëtare nuk kishin zbatuar kriteret përkatëse, përkatësisht nëse është dhënë kontribut në një debat me interes publik; fama e personit në fjalë; sjellja e tij të mëparshme; përmbajtja, forma dhe pasojat e deklaratës në fjalë; dhe ashpërsia e sanksionit të vendosur (sikurse deklarohet në [Axel Springer AG kundër Gjermanisë](#), ankimi nr. 39954/08, 7 shkurt 2012, para. 78–95, [Couderc dhe Hachette Filipacchi Associés kundër Francës](#), aplikimi nr. 40454/07, 10 nëntor 2015, para. 82–93) dhe, duke qenë kështu, i zbatoi vetë këto kriteret. Gjykata shtoi se statusi i kërkuesit si zyrtari shtetëror më i lartë dhe statusi i avokatit si avokat ishin gjithashtu të rëndësishëm.

Gjykata theksoi se avokati nuk kishte qenë personazh publik; se ai nuk kishte bërë asnjë deklaratë publike në lidhje me kërkesën; dhe se ai nuk kishte hyrë me vetëdije në sferën publike. Për rrjedhojë, nuk mund të pritet që ai të tolerojë një shkallë më të lartë kritike sesa një individ i zakonshëm. Ndërkohe që kërkuesi kishte të drejtë të mbrohej kundër akuzave, ai kishte shkuar përtej kësaj dhe kishte vendosur ta fyente avokatin. Duke vepruar kështu, ai nuk kishte dhënë asnjë kontribut në një debat për një çështje me interes publik dhe kishte shkuar përtej kufijve të kritikës së pranueshme. Gjykata theksoi se kërkuesi ishte Presidenti i shtetit në atë kohë, komentet e të cilin u morën nga media të ndryshme dhe, për pasojë, i shkaktuan dëm më të madh reputacionit të avokatit. Gjykata theksoi më tej statusin e avo-

katit, analizoi shfaqjen e ngacmimeve, kërcënimeve dhe sulmeve kundër avokatëve në shumë vende dhe u shpreh se deklarata të tilla si ato të kërkuesit shpesh mund të përbëjnë kërcënim për avokatët për të parandaluar ushtrimin e detyrave të tyre profesionale. Në fund, Gjykata mori parasysh se, për shkak të sekretit hetimor, avokati nuk mund t'i përgjigjej pretendimeve të kërkuesit. Për të gjitha këto arsye, konstatimi i shpifjes nuk përbën shkelje të së drejtës së kërkuesit për lirinë e shprehjes. Gjykata konstatoi se ndërsa vlera e dëmshpërblimit ishte relativisht e lartë, ajo ishte e justifikuar në rrethanat përkatëse.

Si aspekt më vete, Gjykata konstatoi se kohëzgjatja e procesit gjyqësor në apel, katër vjet e shtatë muaj në dy nivele juridiksioni, ishte e tepruar dhe shkelte kërkesën e Nenit 6 të Konventës që proceset gjyqësore duhet të kryhen brenda një kohe të arsyeshme.

Shënim: Disa politikanë duket se mendojnë se përdorimi i gjuhës së ashpër i ndihmon ata të lidhen me elektoratin. Por, kjo ka një kosto: ajo përcakton tonin për ashpërsim të qëndrimeve dhe, sikurse e thekson Gjykata, legjitimon sulmet kundër avokatëve dhe të tjerëve që marrin përsipër kauza jopopullore, si mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe gazetarët e pavarur. Gjykata nuk sheh asnjë vlerë në mbrojtjen e një gjuhe të tillë. Një qasje, e përdorur në [Rujak kundër Kroacisë](#), ankimi nr. 57942/10, vendimi datë 2 tetor 2012, çështje të cilën qeveria i kishte kërkuar Gjykatës që ta përdorte në gjykimin e saj, konstaton se gjuha e përdorur nga Presidenti bie jashtë fushës së veprimit të Nenit 10 (në çështjen [Rujak](#), Gjykata kishte vendosur se “klasa të caktuara fjalimesh, të tilla si fjaliomet e shturura dhe të turpshme, nuk kanë asnjë rol thelbësor në shprehjen e ideve” dhe shpalli të papranueshme *ratione materiae* aplikimin e një ushtari të dënuar për fyerje të eprorit). Gjykata nuk shkoi aq larg këtu, megjithatë u shpreh se fyerja personale e drejtuar ndaj avokatit shkonte përtej kufijve të kritikës së pranueshme dhe nuk jepte asnjë kontribut në një debat për një çështje me interes publik. Gjykata nuk e vlerëson përdorimin e paarsyeshëm të gjuhës së ashpër. Deklaratat “fyese” dhe “tronditëse” mbrohen, sipas çështjes [Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), vetëm kur ato shërbejnë për të komunikuar një

argument më të gjerë për një çështje me interes publik dhe deklarata në fjalë nuk e kalon kufirin dhe bëhet pa arsye fyese.

Oganezova kundër Armenisë, *vendim, datë 17 maj 2021, ankimi nr. 71367/12*

Faktet e çështjes

Kërkuesja është një aktiviste e njohur për të drejtat e personave lesbike, homoseksuale, biseksuale dhe transgjjinorë (LGBT). Ajo shfaqej shpesh në media dhe pas transmetimit të një interviste ku fliste për pjesëmarrjen e saj në Marshimin e Krenarisë, ajo u bë objekt i një fushate urrejtjeje, intimidimi dhe kërcënimesh në internet. Menjëherë pas kësaj, pati disa incidente të personave të ekstremit të djathtë që hynë në një lokal që ajo kishte në bashkëpronësi. Ata arritën të ngacmonin persona si brenda ashtu dhe jashtë lokalit. Më pas, pati një përpjekje për zjarrvënie në lokal, e cila çoi në një hetim të policisë dhe akuza të ngritura kundër dy individëve të ekstremit të djathtë. Pas sulmit me zjarrvënie, pati disa incidente të tjera në lokal, duke përfshirë shkrimet homofobike me grafit, vandalizimin e pjesës së brendshme të lokalit me simbole të krahut të djathtë dhe grumbullime intimiduese të njerëzve të krahut të djathtë. U krijua një grup në Facebook i quajtur "Jo homoseksualitetit!" ku u postuan fotografi të kërkueses dhe të aktivistëve të tjerë si dhe disa komente urrejtjeje, duke përfshirë dhe se kërkuesja "duhet të vdesë", "duhet djegur" dhe "[duhet të] vendoset në një karrige elektrike". Një video në YouTube e sulmit me zjarrvënie tërhoqi gjithashtu komente homofobike dhe kërcënime për vdekje. Kërkuesja kërkoi mbrojtje nga policia, e cila ia dha mbrojtjen, por vetëm për pesë ditë. Disa parlamentarë dhe politikanë të rangut të lartë i mbështetën sulmet. Më pas, kërkuesja u largua nga vendi dhe iu dha azil në Suedi sepse ajo ishte persekutuar për shkak të orientimit të saj seksual. Dy persona u shpallën fajtorë për sulmet, por atyre iu dha vetëm një dënim me kusht dhe më vonë morën amnisti. Kërkuesja u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke pretenduar shkelje të Neneve 3, 8 dhe 14

të Konventës, në lidhje me të drejtën për të mos u trajtuar në mënyrë çnjerëzore ose poshtëruese; të drejtën për respektim të jetës private; dhe të drejtën për të gëzuar të drejtat e Konventës pa diskriminim.

Arsyetimi i Gjykatës

Kjo përmbledhje përqendrohet te aspektet e gjuhës së urrejtjes të çështjes.

Gjykata fillimisht diskutoi nëse trajtimi i pësuar nga kërkuesja arrinte pragun e Nenit 3, i cili siguron të drejtën për mostrajtim çnjerëzor ose poshtërues. Gjykata ritheksoi se trajtimi që poshtëron ose ul një individ, qoftë në sytë e të tjerëve ose në sytë e viktimës, duke treguar mungesë respekti ose duke ulur dinjitetin njerëzor të tij/saj, ose trajtimi që ngjall ndjenjë frike, ankthi ose inferioriteti, e aftë për të thyer rezistencën morale dhe fizike të një individ, mund të karakterizohet si degradues. Fushata e qëndrueshme dhe agresive homofobike kundër kërkueses, përfshirë gjuhën e urrejtjes, e arrin këtë prag, veçanërisht duke pasur parasysht ndjenjën e përgjithshme negative ndaj komunitetit LGBT në Armeni. Situata u përkeqësua nga përgjigja e policisë, e cila vendosi masa mbrojtëse më shumë se një javë pasi kërkuesja i kishte kërkuar ato dhe e kishte ndërprerë mbrojtjen pas vetëm pesë ditësh. Ndërsa përgjigja e autoriteteve ndaj sulmit të zjarrvënies kishte qenë e menjëhershme dhe e shpejtë në mënyrë të aryeshme, policia injoroi qëllimin e qartë homofobik të zjarrvënies dhe akuzat e ngritura ishin vetëm për "dëmtim të qëllimshëm të pronës". Për rrjedhojë, motivi i urrejtjes së sulmit me zjarr u injorua, duke e bërë këtë aspekt themelor të krimit të padukshëm dhe pa rëndësi penale. Gjykata vendosi se një indiferencë e tillë ndaj motivit ishte e barabartë me pranimin zyrtar të tij, apo edhe pajtimin me krimet e urrejtjes.

Gjykata ishte veçanërisht kritike ndaj reagimit të autoriteteve ndaj fushatës së gjuhës homofobike të urrejtjes dhe frikësimit që kërkuesja kishte pësuar pas sulmit me zjarrvënie. Abuzimi i drejtuar kundër kërkueses në mediat sociale përfshinte thirrje të shumta të drejtpërdrejta për dhunë si dhe ko-

mente përgjithësisht homofobike. Ajo e raportoi rastin në polici, kjo e fundit nuk bëri asgjë për ta ndjekur rastin. Gjykata deklaroi se megjithëse jo çdo shprehje e gjuhës së urrejtjes duhet të pasjellë ndjekje penale dhe sanksione penale, shteti ka detyrimin pozitiv për të marrë masa të caktuara. Gjykata përsëriti se sulmet ndaj personave të kryera duke fyer, tallur ose shpifur për grupe të caktuara të popullsisë mund të jenë të mjaftueshme që autoritetet të nisin luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Kur gjuha e urrejtjes rritet në një nivel që kërcënon integritetin fizik ose mendor të një personi, vetëm mekanizmat efikasë të së drejtës penale mund të sigurojnë mbrojtjen e duhur dhe të shërbejnë si parandalues. Gjykata konstatoi se komentet e urrejtjes në çështjen në fjalë përmbanin thirrje të pakamuflluara për dhunë ndaj kërkueses, të cilat kërkonin mbrojtje nga legjislacioni penal. Duke pasur parasysh aktet aktuale të dhunës, duke përfshirë sulmin me zjarrvënie në klub dhe sulmet homofobike të mëvonshme kundër kërkueses, autoritetet duhet t'i kishin marrë akoma më seriozisht komentet e urrejtjes të postuara në platformat e mediave sociale. Në vend të kësaj, parlamentarë dhe politikanë të rangut të lartë bënë publikisht deklarata intolerance duke mbështetur sulmin me zjarrvënie. Përmes gjithë kësaj, autoritetet nuk arritën t'i përgjigjen në mënyrë të përshtatshme gjuhës së urrejtjes homofobike kundër kërkueses. Për të gjitha këto arsye, Gjykata njëzëri konstatoi se kishte pasur shkelje të Nenit 3 të marrë në lidhje me Nenin 14 të KEDNJ-së.

Shënim: Kjo është një nga pak çështje ku gjuha e urrejtjes ishte e një ashpërsie të tillë që u bë objekt i fushës së veprimit të Nenit 3 të Konventës, i cili ndalon trajtimin çnjerëzor ose poshtëruar. Sikurse u shpreh Gjykata, "kur trajtimi poshtëron ose nënçmon një individ, qoftë në sytë e të tjerëve ose në sytë e viktimës, duke treguar mungesë respekti ose duke ulur dinjitetin njerëzor të personit në fjalë, ose duke ngjallur ndjenja frike, ankthi ose inferioriteti, të afta për të thyer rezistencën morale dhe fizike të një individ, ai mund të cilësohet si degradues dhe gjithashtu të jetë objekt i ndalimit të parashikuar në Nenin 3", edhe kur nuk ka dëmtim fizik. Është tronditëse se si çështjet e tjera ku Gjykata ka konstatuar se gjuha e urrejtjes është aq e rëndë sa të përfshihet

në fushën e veprimit të Nenit 3 (për shembull, [Identoba dhe të Tjerët kundër Gjeorgjisë](#), ankesa nr. 73235/12, 12 maj 2015, dhe [M.C. dhe A.C. kundër Rumanisë](#), ankesa nr. 12060/12, 12 prill 2016) kanë të bëjnë gjithashtu me gjuhën e urrejtjes kundër LGBT-ve. Sikurse është raportuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, ka pasur një rritje të dukshme të gjuhës së urrejtjes kundër komunitetit LGBT dhe krimeve të tjera të urrejtjes në shumë vende, duke përfshirë, në mënyrë tronditëse, edhe figura dhe liderë politikë, përfshirë përfaqësues të qeverisë ([Lufta e urrejtjes në rritje kundër personave LGBTI në Evropë, Rezoluta 2417 \(2022\)](#)). Duke vendosur se një gjuhë e tillë urrejtjeje shkel Nenin 3 të Konventës, një shkelje e rëndë kjo e Konventës, Gjykata u dërgon një sinjal të fortë shteteve se duhet të bëjnë më shumë për ta ndjekur penalisht atë dhe në përgjithësi të sigurojnë që të gjithë njerëzit nën juridiksionin e tyre të jenë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre pa diskriminim.

[Zurek kundër Polonisë, vendim, datë 16 qershor 2022, ankimi nr. 39650/18](#)

Faktet e çështjes

Kërkuesi është gjyqtar dhe ish-zëdhënës i Gjykatës Rajonale të Krakovës dhe anëtar i Këshillit Kombëtar Gjyqësor (KKGJ). KKGJ-ja është organ kushtetues i ngarkuar me ruajtjen e pavarësisë së gjykatave dhe gjyqtarëve. Një nga funksionet kryesore të saj është vlerësimi dhe përzgjedhja e kandidatëve për emërim në funksione gjyqësore për çdo nivel dhe lloj gjykate. Kërkuesi u rizgjodh në vitin 2014 për një mandat katërvjeçar dhe u emërua si zëdhënës. Si i tillë, ai është shfaqur shpesh në media dhe ka marrë pjesë edhe në mbledhjet e komiteteve parlamentare. Duke filluar nga viti 2015, në gjyqësorin polak u bënë ndryshime të shumta, me pretendimin për të rritur efikasitetin e administrimit të drejtësisë dhe për t'i bërë më demokratike zgjedhjet e anëtarëve të KKGJ-së. Pati një debat të ashpër publik rreth kësaj, si pjesë e të cilit qeveria financoi një fushatë me stenda ku theksoheshin aktivitetet e pretenduara si joetike ose të

paligjshme të disa gjyqtarëve. Kërkuesi mori pjesë në debate publike, duke shprehur fuqishëm kritikën e tij dhe të KKGJ-së, zëdhënës i të cilit ai ishte, për reformat e propozuara. Në vitin 2017, u miratua legjislacioni që parashikonte që anëtarët e KKGJ-së që vinin nga gjyqësori do të zgjidheshin nga Parlamenti dhe se mandati i anëtarëve gjyqësorë në detyrë do të ndërpritej. Legjislacioni u prit me kritika në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Legjislacioni hyri në fuqi dhe kërkuesit iu ndërpre mandati në KKGJ. Ndërsa debati publik rreth legjislacionit ishte i vazhdueshëm dhe kërkuesi shfaqej shpesh në media, ai iu nënshtrua një sërë masash të tjera, duke përfshirë një auditim 17-mujor për antikorrupsion, inspektim të punës së tij në Gjykatën Rajonale të Krakovës, deklasifikim të deklaratës së tij financiare për vitin 2018, dhe disa procedura disiplinore të cilat ishin në fuqi në kohën e dorëzimit të ankimit para Gjykatës. Ai u hoq gjithashtu nga pozicioni i Zëdhënësit të Gjykatës Rajonale të Krakovës. Kërkuesi u ankua në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes, si dhe të së drejtës së tij për proces të rregullt gjyqësor. Kjo përmbledhje përqendrohet te pjesa e ankesës e lidhur me të drejtën për lirinë e shprehjes.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjatë vlerësimit nëse kishte pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për lirinë e shprehjes, Gjykata mori parasysh tërësinë e të gjitha hapave që ishin ndërmarrë kundër tij, duke mos e marrë secilin hap veç e veç. Ato ishin: shkarkimi i tij si zëdhënës, auditimi, inspektimi i punës së tij dhe deklasifikimi i deklaratës së tij financiare. Në lidhje me përfundimin e mandatit të tij, Gjykata vuri në dukje se kjo kishte prekur të gjithë anëtarët e KKGJ-së dhe jo vetëm kërkuesin. Gjykata gjithashtu mori parasysh kontekstin më të gjerë të dobësimit të pavarësisë së gjyqësorit në vend, sikurse Gjykata kishte konstatuar në vendime të mëparshme. Duke marrë parasysh të gjitha këto, Gjykata konstatoi se ekzistonte një lidhje e qartë shkak-pasojë midis ushtrimit të së drejtës për

lirinë e shprehjes nga kërkuesi dhe masave të marra kundër tij nga autoritetet.

Gjykata më pas shqyrtoi nëse ndërhyrja në lirinë e shprehjes së kërkuesit ishte e justifikuar. Gjykata vuri në dukje se ndërhyrjet ishin parashikuar me ligj, por shprehu dyshimin nëse ato kishin ndjekur një qëllim legjitim. Gjykata e përqendroi analizën e saj nëse ndërhyrja kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike. Gjykata rikujtoi se parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën e lirisë së shprehjes së gjyqtarëve, sikurse përcaktohet në [Baka kundër Hungarisë](#) (ankimi nr. 20261/12, 23 qershor 2016), kërkojnë që gjyqtarët të ushtrojnë diskrecion maksimal për të ruajtur imazhin e tyre si gjyqtarë të paanshëm për sa i përket çështjeve specifike, por që çdo kufizim ndaj deklaratave që ata bëjnë në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë duhet të shqyrtohet nga afër. Gjykata kujtoi gjithashtu "efektin frenues" që frika ndaj sanksionit ka në lidhje me ushtrimin e lirisë së shprehjes, veçanërisht mbi gjyqtarët e tjerë që dëshirojnë të marrin pjesë në debatin publik për çështje që lidhen me administrimin e drejtësisë dhe gjyqësorin.

Duke zbatuar këto parime në çështjen nën shqyrtim, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi kishte shprehur pikëpamjet e tij për reformat legjislative në cilësinë e tij profesionale si anëtar gjyqësor i KKGJ-së dhe si zëdhënës i saj. Prandaj, ai kishte jo vetëm të drejtën, por edhe detyrën të shprehej. Kur një gjyqtar bën deklaratë në emër të një këshilli gjyqësor, shoqate gjyqësore ose organi tjetër përfaqësues të gjyqësorit, mbrojtja që i ofrohet atij gjyqtari rritet. Gjykata rikujtoi më tej se instrumentet ligjore të Këshillit të Evropës pranojnë se çdo gjyqtar është përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit dhe se gjyqësori duhet të konsultohet dhe të përfshihet në përgatitjen e legjislacionit në lidhje me funksionimin e sistemit gjyqësor. Gjykata vuri në dukje se kërkuesi në asnjë moment nuk kishte kritikuar anëtarët e tjerë të gjyqësorit, por se komentet e tij ishin kufizuar thjesht tek funksionimi i sistemit gjyqësor. Deklaratat e tij nuk kishin shkuar përtej kritikave të thjeshta nga një këndvështrim rreptësisht profesional.

Gjykata vuri në dukje se secila prej masave të marra kundër kërkuarit dukej se kishte ardhur si përgjigje ndaj deklaratave që ai kishte bërë dhe përbënte ngacmim: auditimi, i cili zgjati shtatëmbëdhjetë muaj dhe ishte i diskutueshëm nga pikëpamja procedurale, nuk dha rezultate konkrete; inspektimi i punës së kërkuarit erdhi një ditë pas marrjes së një letre anonime, e cila ankohej për komentet kritike të kërkuarit për reformën në gjyqësor; shkarkimi i tij si zëdhënës i Gjykatës Rajonale erdhi pa konsultimin e nevojshëm dhe vetëm disa ditë pasi Ministri i Drejtësisë kishte emëruar një kryetar të ri të Gjykatës Rajonale të Krakovës; ndërsa deklarata financiare e kërkuarit ishte deklasifikuar pa dhënë asnjë arsye. Gjykata u shpreh se të marra së bashku, këto masa mund të shiheshin si strategji që synon frikësimin apo edhe heshtjen e kërkuarit. Gjykata u shpreh se masat padyshim kishin një “efekt frenues” dhe duhet të kenë dekurajuar jo vetëm atë, por edhe gjyqtarët e tjerë nga pjesëmarrja në debatin publik për reformat legjislative. Asnjë nga këto nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Për rrjedhojë, Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes.

Shënim: Gjykata i referohet shprehimisht [Magna Carta-s së Gjyqtarëve Evropianë](#), një grup parimesh themelore mbi pavarësinë, paanshmërinë dhe kompetencën e gjyqtarëve, e hartuar nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, e cila thotë se: “çdo gjyqtar [është] përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.” Gjykata citon gjithashtu [Deklaratën e Sofjes mbi Pavarësinë dhe Përgjegjshmërinë e Sistemit të Drejtësisë të Rrjetit Evropian të Këshillave Gjyqësorë](#), e cila përcakton “detyrën kolektive të gjyqësorit evropian për të deklaruar qartë dhe bindshëm kundërshtimin e tij ndaj propozimeve të qeverisë që tentojnë të minojnë pavarësinë të gjyqtarëve individualë ose Këshillave Gjyqësorë”. Sikurse thekson Gjykata, kërkuari kishte detyrën virtuale të protestonte ndaj kërcënimeve ndaj pavarësisë së gjyqësorit, si gjyqtar dhe veçanërisht për shkak të pozicionit të tij si zëdhënës i gjykatës rajonale dhe zëdhënës i Këshillit Kombëtar Gjyqësor. Prandaj, Gjykata konstatoi, njëzëri, se fushata e hakmarrjes dhe përndjekjes me të cilat u përball kër-

kuesi, shkelte të drejtën e tij për lirinë e shprehjes. Autoritetet e brendshme kanë vazhduar fushatën e tyre kundër tij: më 30 maj, u raportua se kërkuari përballëj me [64 akuza të reja disiplinore](#). Kjo situatë duhet ta bëjë Komitetin e Ministrave të mbikëqyrë më mirë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës.

Drouiotis kundër Qipros, vendim, datë 5 korrik 2022, ankimi nr. 42315/15

Faktet e çështjes

Kërkuari është gazetar në një gazetë kombëtare që boton një rubrikë të rregullt ku komentohen çështjet aktuale politike. Gazeta kishte botuar artikuj të cilat komentonin zgjatjen e kontratës së punës së një avokati të lartë në Zyrën Ligjore të qeverisë përtej moshës së pensionit. Në artikuj vihej në dukje se ndërsa emërime të tilla në të kaluarën konsideroheshin si një “formë e papranueshme e favorizimit politik”, qeveria tashmë e mbronte këtë praktikë si çështje “të interesit publik”. Në rubrikën e tij, kërkuari e komentoi ashpër këtë çështje, duke thënë se avokati po “puthej” me Presidentin e Dhomës së Përfaqësuesve në mënyrë që të emërohej Prokuror i Përgjithshëm dhe citonte nga një libër që avokati kishte shkruar për të sugjeruar që avokati ishte paranojak. Më pas, avokati paditi për shpifje, duke argumentuar se artikulli ishte shkruar me keqbesim për të dëmtuar imazhin e tij dhe opinionin e publikut për të. Gjykata kombëtare vendosi në favor të tij dhe i dha avokatit 25,000 Euro dëmshpërblim si dhe urdhëroi mbulimin e shpenzimeve ligjore prej 3,472,59 Eurosh. Ankimi ne apel i gazetarit u rrëzua. Kërkuari u ankua në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për shkelje të së drejtës së tij për lirinë e shprehjes.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjkata theksoi se çështja kishte të bënte me një konflikt të së drejtës së kërkuarit për lirinë e shprehjes, e mbrojtur sipas

Nenit 10 të Konventës, dhe të drejtës së avokatit për mbrojtjen e reputacionit të tij, sipas Nenit 8. Gjykata pranoi se artikulli i kërkuetit, duke e paraqitur avokatin si servil dhe komentimi negativ për zgjatjen e mandatit të tij, ishin në gjendje t'i prishnin atij reputacionin dhe i kishin shkaktuar paragjykim në mjedisin e tij profesional dhe social. Kjo arrinte në nivelin e nevojshëm të ashpërsisë për të zbatuar të drejtat e avokatit sipas Nenit 8.

Gjykata më pas shqyrtoi nëse artikulli kontribuonte për një debat me interes të përgjithshëm. Duke vënë në dukje se ai ishte botuar menjëherë pas publikimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për zgjatjen e mandatit të avokatit, vendim i cili kishte shkaktuar polemika dhe debate të konsiderueshme politike dhe që ishte komentuar në media të tjera, Gjykata u shpreh se artikulli kontribuonte për një debat në interes të përgjithshëm. Gjykata u shpreh gjithashtu se avokati mund të krahasohej me një personazh publik. Ai ishte një nëpunës i lartë civil që kishte hyrë vetë në sferën publike duke komentuar shpesh në media për çështje të ndryshme dhe po konsiderohej për postin e Prokurorit të Përgjithshëm, post që ai aspironte. Për rrjedhojë, ai e kishte ekspozuar veten ndaj një analizimi të imët të veprimeve të tij dhe duhet të tregonte një shkallë më të madhe tolerance ndaj kritikës sesa individët e zakonshëm.

Sa i përket natyrës së komenteve fyese dhe bazës së tyre faktike, Gjykata vuri në dukje se ato nuk kishin të bënin me jetën private të avokatit, por me punën e tij profesionale dhe u bënë në kontekstin e një debati të nxehtë politik. Seksioni i gazetës së kërkuetit ishte krijuar për të komentuar mbi çështje të tilla. Të tjerë kishin shprehur shqetësime të ngjashme, megjithëse në një mënyrë më pak të ekzagjuar, dhe shprehjet padyshim të forta dhe të vrazhda të kërkuetit duhet të lexohen brenda këtij konteksti më të gjerë. Gjykatat kombëtare nuk i kishin përfshirë vërtet këta faktorë në vlerësimin e tyre. Kërkueti kishte zgjedhur të përçonte kritikën e tij të fortë përmes një stili kaustik dhe ironik, i cili, sipas tij, synonte të ngjallte polemika, të provokonte publikun dhe të tërhiqte vëmendjen e tij. Nuk ishte botuar me keqbesim. Gjykata përsëriti se gazetarët

mund të ekzagjuojnë dhe madje të provokojnë, se disa shprehje që tërheqin vëmendjen nuk ngrenë në vetvete një çështje sipas jurisprudencës së Gjykatës dhe se stili është pjesë e komunikimit dhe mbrohet së bashku me përmbajtjen e shprehjes.

Gjykata theksoi gjithashtu se deklaratat e bëra nga kërkueti ishin gjykime vlerësuese dhe jo pretendime fakti. Ato kishin një bazë faktike, pasi botimet e mëparshme kishin treguar se vendimi për zgjatjen e mandatit të avokatit ishte në kundërshtim me qëndrimin e mëparshëm të qeverisë në raste të ngjashme. Edhe pse ai nuk kishte një bazë të fortë për të pretenduar se Prokurori i Përgjithshëm nuk ishte informuar për vendimin, Gjykata përsëriti se pasaktësitë faktike duhet të tolerohen nëse botohen me mirëbesim dhe nëse të shprehurit në fjalë ka të bëjë me tema kontraversale. Në fund, Gjykata vendosi se shuma e dëmshpërblimit e dhënë nga gjykata kombëtare kishte qenë joproporcionale me çdo dëm të mundshëm të shkaktuar mbi reputacionin e avokatit. Kjo sidomos duke pasur parasysh se ndërkohë që ishin ende pezull proceset gjyqësore në shkallë të parë, ai ishte emëruar Zëvendësprokuror i Përgjithshëm. Për të gjitha këto arsye, Gjykata konstatoi shkelje të së drejtës së lirisë së shprehjes.

Shënim: Ka dy gjëra që ia vlen të theksohen në këtë çështje. Së pari, gjykatat kombëtare e kishin përqendruar analizën e tyre tek fjalët e ashpra të përdorura nga kërkueti dhe toni i rubrikës së tij, pa marrë parasysh debatin më të gjerë publik rreth çështjes, statusin e gazetarit dhe natyrën polemike të rubrikës. Fjalët e përdorura nga gazetari në këtë çështje (akuza për «t'u puthur» me Kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve; dhe se «regjimi» «pëshlyt mbi logjikën, fyen inteligjencën normale dhe promovon paranojën») nuk janë aq të ashpra dhe të vrazhda sa sugjerimi i bërë nga Presidenti i Kroacisë në çështjen *Mesić* (e përmbledhur gjithashtu në këtë buletin) që avokati i përfshirë në atë çështje duhet të vizitohej në një klinikë psikiatrike. Çfarë është e rëndësishme është se dinamika e pushtetit në këtë rast është e përmbysur – avokati që kritikohet është në pozitë pushteti, gazetari jo – dhe nuk ka asnjë lidhje më të gjerë me çështjen e sigurisë së avokatëve. Pika

e dytë ku ia vlen të përqendrohemi është dhënia e shpërblimit të dëmit nga gjykata, duke u shprehur se shuma 25,000 euro është “jashtëzakonisht e lartë në terma absolute”. Kjo vendos një pikë referimi të qartë.

Tagiyeva kundër Azerbajxhanit, vendim, datë 7 korrik 2022, Ankimi nr. 72611/14

Faktet e çështjes

Çështja ka të bëjë me bashkëshortin e kërkueses, një shkrimtar dhe reporter i njohur, i cili u godit me thikë për vdekje nga një person i panjohur. Ai shkruante artikuj, ese dhe rubrika në lidhje me çështje të ndryshme sociale, përfshirë vendin e fesë në shoqëri dhe përhapjen e saj si ideologji politike. Ai ishte veçanërisht kritik ndaj ndikimit të Iranit në Azerbajxhan dhe në botë. Pas botimit të një artikulli në nëntor të vitit 2006, një udhëheqës fetar iranian lëshoi një thirrje për vdekjen e kërkuetit. Kërkueti dhe familja e tij u vunë nën mbrojtjen e policisë, por kërkueti u ndoq penalisht dhe u shpall fajtor për nxitje të urrejtjes për shkak të racës (në dhjetor 2019: Gjykata më vonë konstatoi se dënimi ishte në kundërshtim me Nenin 10). Ai u fal në dhjetor të vitit 2007 dhe vazhdoi të shkruante. Ai nuk ishte më nën mbrojtjen e policisë. Në nëntor të vitit 2011, ai botoi një artikull që kritikonte natyrën fetare dhe totalitare të shtetit iranian dhe politikën e tij ndaj botës. Nëntë ditë më vonë, ai u godit me thikë. Ai vdiq në spital katër ditë më vonë. Para vdekjes, policia e mori atë në pyetje. Ai deklaroi se nuk kishte marrë asnjë kërcënim për vdekje. Gruaja dhe familja e tij nuk kishin qenë në dijeni të ndonjë kërcënimi kundër tij, përveç thirrjes për vdekje të vitit 2006. Hetimet e policisë ishin të pasuksesshme për identifikimin e sulmuesit. Kërkueses iu refuzua aksesimi në dosjen hetimore deri pas përfundimit të hetimit. Kërkuësja u ankua pa sukses tek autoritetet e brendshme për moskryerjen e një hetimi efektiv dhe më pas u ankua në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata shqyrtoi ankesën në bazë të Nenit 2 të Konventës, sipas të cilit shteti ka detyrimin pozitiv për të mbrojtur të drejtën e jetës dhe, kur dikush sulmohet dhe vdes, ka detyrimin të kryejë një hetim të shpejtë, të pavarur dhe efektiv.

Në lidhje me detyrën për të mbrojtur, pika kritike në këtë çështje ishte nëse autoritetet kombëtare ishin në dijeni ose duhet të ishin në dijeni të ekzistencës së një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e bashkëshortit të kërkueses dhe, nëse po, nëse ato dështuan të marrin masa për të shmangur këtë rrezik. Gjykata vlerësoi se as kërkuësja dhe as bashkëshorti i saj nuk kishin marrë ndonjë kërcënim pas botimit të artikullit të tij të fundit dhe se autoritetet nuk kishin qenë në dijeni të një kërcënimi aktual për jetën e kërkuetit. Duke marrë parasysh informacionin përpara saj, Gjykata nuk ishte e bindur se thirrja për vdekje e nëntorit e vitit 2006 kishte çuar në një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën e bashkëshortit të kërkueses në vitin 2011. Gjykata u shpreh se duke pasur parasysh vështirësitë e lidhura me policimin e shoqërive moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhen bërë në aspektin e prioritetëve dhe burimeve, fushëveprimi i detyrimit të shtetit për të mbrojtur duhet të interpretohet në një mënyrë që të mos imponojnë një barrë të pamundur ose joproporcionale për autoritetet. Jo çdo rrezik i pretenduar për jetën mund të sjellë nevojën që autoritetet të marrin masa operacionale për të parandaluar materializimin e këtij rreziku në bazë të Konventës. Gjykata përsëriti se bashkëshorti i kërkueses nuk kishte aplikuar kurrë para autoriteteve kombëtare ose nuk i kishte informuar ato për ndonjë rrezik apo kërcënim për jetën e tij përpara se ta sulmonin me thikë.

Duke iu kthyer pretendimit për dështim të autoriteteve për të kryer një hetim efektiv, Gjykata vërejt se procesi penal u nis menjëherë pas sulmit me thikë të bashkëshortit të kërkueses. Gjykata përsëriti se detyrimi sipas Nenit 2 të Konventës për të hetuar nuk është një detyrim për rezultat, por detyrim për mjete. Në çështjen konkrete, u

kryen një sërë veprimesh hetimore përkatëse dhe në kohë dhe autoritetet hetuese eksploran motive të ndryshme të mundshme pas vrasjes së bashkëshortit të kërkueses. Gjykata nuk vuri re asnjë mangësi në këtë drejtim.

Megjithatë, Gjykata nuk identifikoi asnjë arsye pse kërkueses i ishte mohuar aksesit tek materialet përkatëse të çështjes gjatë hetimit. Kjo i mohoi kërkueses mundësinë për të mbrojtur interesat e saj legjitime dhe pengoi shqyrtimin e mjaftueshëm të hetimit nga publiku. Gjykata theksoi rëndësinë e përfshirjes së familjeve të të ndjerëve ose përfaqësuesve të tyre ligjorë në hetim dhe dhënies së informacionit për ta, si dhe mundësimin e tyre për të paraqitur prova të tjera. Për këtë arsye, Gjykata konstatoi shkelje të Nenit 2 të Konventës.

Shënim: Gjatë dekadës së fundit, ka pasur një përqendrim të dukshëm të sigurisë së gazetarëve në të gjithë Evropën. Platforma e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Gazetarisë dhe Sigurinë e Gazetarëve ([Platform for the Protection of Journalism and Safety of Journalists](#)), e krijuar në vitin 2015, tregon 26 raste mosndëshkimi për vrasjen e gazetarëve (që do të thotë raste ku përgjegjësit nuk janë sjellë para drejtësisë) dhe një rritje të ndje-

shme të sulmeve kundër gazetarëve që nga viti 2020. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka marrë vendime mbi disa çështje të lidhura me dhunën ndaj gazetarëve dhe ka ndërtuar një jurisprudencë që përcakton një sërë parimesh dhe detyrash thelbësore për shtetet. Kryesorja midis tyre është detyra për të mbrojtur, e cila përfshin detyrën për të ndërmarrë veprime parandaluese kur shtetet ndërgjegjësohen për një kërcënim të besueshëm. Në këtë çështje, Gjykata thekson se vështirësitë e policimit të shoqërive moderne, paparashikueshmëria e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operationale që duhet të bëjë policia, nënkuptojnë se mund të jetë e vështirë për shtetet të përmbushin detyrën e tyre për të parandaluar. Gjykata thekson se kërcënimet për vdekje ndaj Tagiyev-it e ka zanafillën pesë vjet para vrasjes së tij dhe nuk ishte përsëritur deri kur ai u sulmua papritmas. Por, duke pasur parasysh rritjen e dhunës ndaj gazetarëve dhe klimën e vazhdueshme të mosndëshkueshmërisë për krime të tilla, ndoshta autoritetet e brendshme duhet të jenë më vigjilente. Një muaj pas botimit të këtij gjykimi, Salman Rushdie u godit me thikë nga një ekstremist fetar, i cili veproi në bazë të një thirrjeje për vdekje të para një dekade për të vrarë Rushdie-n.

Analizë e thelluar e çështjeve të përzgjedhura

OOO Memo kundër Rusisë, vendim, datë 15 mars 2022, ankimi nr. 2840/10

Faktet e çështjes

Kërkuese është kompania që publikon median online [Kavkazskiy Uzel](#) (Nyja Kaukaziane), e cila raporton mbi situatën politike dhe të drejtave të njeriut në rajonin e Kaukazit. Në vitin 2008, ajo botoi një artikull që raportonte se pagesa e një subvencionit nga Rajoni i Volgogradit në qytetin e Volgogradit ishte pezulluar. Raporti citonte një ekspert të Fondit për Zhvillimin e Politikave të Informacionit, i cili thoshte se një nga arsytet pse ishte pezulluar subvencionit ishte për shkak se qyteti i Volgogradit nuk i kishte dhënë një tender për autobusë të rinj një kompanie vendase që ishte e favorizuar nga administrata rajonale. Eksperti citohej të kishte thënë se: “zyrtarët e administratës erdhën në zyrën e kryetarit të Bashkisë duke thënë: “Si nuk e mbështetët prodhuesin vendas!” Duket se refuzimi i zyrës së kryetarit të Bashkisë për të bërë biznes me fabrikën e Volzhaninit ishte një nga arsytet kryesore të zemërimit të zyrtarëve rajonalë ... pezullimi i dhënies së subvencioneve për qytetin e Volgogradit nga buxheti rajonal ishte një akt hakmarrjeje për thirrjen e humbur për tender.”

Administrata Rajonale e Volgogradit ngriti padi civile për shpifje kundër kërkuesit, duke kërkuar tërheqje nga artikulli me arsyetimin se deklaratat ishin të rreme dhe kishin njollosur “reputacionin e punës” së administratës. Kompania kërkuese argumentoi se deklaratat e kundërshtuara ishin

gjykime vlerësuese të ekspertit kombëtar dhe se ato kishin të bënin me një çështje me interes publik. Gjykata e Rrethit vendosi në favor të administratës, duke u shprehur se pavarësisht përdorimit të shprehjes “më duket”, akuza e bërë nga eksperti ishte akuzë fakti. Gjykata e Rrethit vlerësoi se pretendimi se po lobonte për interesat e një kompanie të caktuar po dëmtonte reputacionin e punës së Administratës Rajonale dhe urdhëroi tërheqje nga artikulli dhe botimin e vendimit të saj në faqen e internetit të kërkuesit. Apeli i vendimit nga kërkuesi u hodh poshtë dhe, për rrjedhojë, kërkuesi depozitoi një ankim para Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjkata Evropiane e Drejtave të Njeriut e përqendroi analizën e saj nëse dënimi për shpifje ndiqte një “qëllim legjitim” (një nga tre pjesët e “testit” të kërkuar sipas Nenit 10 për të përcaktuar nëse një ndërhyrje është e justifikuar). Ajo vërejti se paditësi në proceset e shpifjes ishte një organ publik dhe se qeveria kishte argumentuar se dënimi për shpifje kishte qenë i nevojshëm për të mbrojtur “reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve”. Gjykata pranoi se kjo mund të shtrihej tek personat juridikë dhe kujtoi se subjekte të tilla si kompanitë ankuese kanë një interes legjitim për mbrojtjen e suksesit dhe qëndrueshmërisë së tyre komerciale, për të mirën e aksionerëve dhe punonjësve, si dhe për të mirën më të gjerë ekonomike. Megjithatë, Gjykata theksoi se këto aspekte nuk vlejné për një organ ekzekutiv të qeverisë që nuk merret në aktivitetet të drejtpërdrejta ekonomike.

Për sa i përket organeve publike që kërkojnë mbrojtje ligjore të reputacionit të tyre, Gjykata vuri në dukje se më parë kishte vendosur se një organ i zgjedhur mund të argumentonte vetëm në rrethana vërtet të jashtëzakonshme se mbrojtja e reputacionit të tij ishte e nevojshme sipas Nenit 10(2), për shembull në kontekstin e proceseve gjyqësore për shpifje të ngritura nga këshilli lokal i një qyteti me një popullsi nën 12,000 banorë ([Lombardo dhe të tjerët kundër Maltës](#), ankimi nr. 7333/06, 24 prill 2007), ku këshilltarët ishin lehtësisht të identifikueshëm.

Në çështjen konkrete, Gjykata vlerësoi se organet ekzekutive të ngarkuara me kompetenca shtetërore janë në thelb të ndryshme nga personat juridikë, duke përfshirë ndërmarrjet publike ose shtetërore, që angazhohen në aktivitete ekonomike konkurruese. Gjykata gjithashtu vërejt se, për të parandaluar abuzimin e pushtetit dhe korrupsionin e organeve publike në një sistem demokratik, aktivitetet e organeve ekzekutive duhet t'i nënshtrohen një shqyrtimi të ngushtë nga opinioni publik. Duke vënë në dukje përdorimin e shpeshtë të çështjeve të shpifjes për të ndaluar kritikën, Gjykata vijoi analizën duke vënë në dukje se në disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, autoritetet vendore dhe organet e tjera publike nuk mund të padisin për shpifje, sepse kjo do të pengonte shqyrtimin e funksionimit të tyre dhe kritikën publike.

Gjykata arriti në përfundimin se interesat e një organi ekzekutiv të ngarkuar me kompetenca shtetërore për të ruajtur një reputacion të mirë janë të ndryshme nga interesat e reputacionit të personave juridikë që konkurrojnë në treg, si dhe nga e drejta për reputacion e personave fizikë. Për rrjedhojë, Gjykata vendosi se proceset gjyqësore civile për shpifje e ngritur nga një organ ekzekutiv, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të konsiderohen se ndjekin qëllimin legjitim të “mbrojtjes së reputacionit ... të të tjerëve”. Gjykata shtoi se kjo nuk i përjashton anëtarët individualë të organeve të tilla të parashtrojnë padi për shpifje në emër të tyre, nëse mendojnë se është dëmtuar reputacioni i tyre personal.

Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata u shpreh se ishte “vështirë të imagjinohej” që paditësi –

organi më i lartë i ekzekutivit të Rajonit të Volgogradit – të kishte një interes në mbrojtjen e suksesit dhe qëndrueshmërisë komerciale të këtij organi, dhe as nuk mund të thuhet se anëtarët e këtij organi ishin po aq “lehtë të identifikueshëm” sa ata të një autoriteti lokal në një qytet të vogël. Prandaj, Gjykata konstatoi se procedurat nuk ndoqën asnjë nga qëllimet legjitime të renditura në Nenin 10 të Konventës dhe se e drejta e kërkuar për lirinë e shprehjes ishte shkelur.

Komente të përgjithshme

Pas disa çështjesh në të cilat Gjykata nuk iu përgjigj pyetjes nëse organet shtetërore duhet të ishin në gjendje të padisin për shpifje (shih kryesisht [Romanenko dhe të tjerët kundër Ruisisë](#), ankimi nr. 11751/03, 8 tetor 2009, dhe [Frisk dhe Jensen kundër Danimarkës](#), ankimi nr. 19657/12, 5 dhjetor 2017), Gjykata tani ka deklaruar se ato nuk munden: “interesat e një organi të ekzekutivit të ngarkuar me kompetenca shtetërore për ruajtjen e një reputacioni të mirë në thelb ndryshojnë nga e drejta për reputacion e personave fizikë dhe interesat e reputacionit të personave juridikë, privatë apo publikë, që konkurrojnë në treg ... Nga kjo rrjedh se proceset civile për shpifje të ngritura, në emër të tij, nga një person juridik që ushtron kompetenca publike, si rregull i përgjithshëm nuk mund të konsiderohen se ndjekin qëllimin legjitim të “mbrojtjes së reputacionit ... të të tjerëve” sipas Nenit 10 § 2 të Konventës” (paragrafët 46, 47). Duke përdorur frazën, “si rregull i përgjithshëm”, Gjykata i lë vetes një prag vlerësimi për çështjet e ardhshme, por megjithatë vendos një standard të qartë.

Është gjithashtu interesante të theksohet se Gjykata i referohet Komitetit të Komisionerit të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës mbi çështjet SLAPP (Koha për të ndërmarrë veprime kundër SLAPP-ve, 27 tetor 2020), duke theksuar ndërgjegjësimin në rritje për rreziqet që sjell nisja e proceseve gjyqësore me synimin për të kufizuar pjesëmarrjen publike për demokracinë, veçanërisht në çështjet kur ekziston një mungesë e qartë ekuilibri midis pushtetit të paditësit dhe të paditurit. Komisioneri paralajmëron se gazetarët, ak-

tivistët dhe grupet mbështetëse janë objektivat e preferuara të të ashtuquajturave SLAPP. Këto çështje SLAPP shpesh vijnë në formën e padive për shpifje dhe janë një mënyrë shumë efektive për ata që janë në pozita pushteti për të t'u mbyllur gojën kritikëve të tyre: për një person të fuqishëm, ngritja e një padie për shpifje është një shpenzim i parëndësishëm, ndërsa për një gazetar ose aktivist që merr një SLAPP shpesh padi të tilla janë të shtrenjta dhe i detyrojnë ata të investojnë kohë dhe burime të konsiderueshme. Duke pasur parasysh rritjen e ndërjegjësimit për SLAPP-et dhe mbizotërimin e çështjeve të shpifjes në rendin e ditës së saj, mund të pritët që Gjykata t'i kthehet kësaj teme gjatë muajve dhe viteve të ardhshme.

NIT S.R.L. kundër Moldavisë, vendim, datë 5 prill 2022, ankimi nr. 28470/12

Faktet e çështjes

Kompania kërkuese është pronare e kanalit televiziv Noile Idei Televizate (New Ideas Televised, NIT), i cili kishte një licencë transmetimi kombëtar në Moldavi nga viti 2004 deri në vitin 2012. Që nga viti 2009, ai ishte transmetuesi kryesor që u jepte kohë televizive opinionëve të partisë kryesore opozitare. Në përdhën nga viti 2009 deri në vitin 2011, ajo mori sanksione të shumta për shkeljen e kërkesave të licencës për neutralitet dhe paanshmëri në emisionet e lajmeve, duke favorizuar partinë opozitare dhe duke transmetuar lajme që konsideroheshin të shtrembëruara. Sanksionet u bënë më të ashpra duke filluar me një paralajmërim publik tek një gjobë, tek ndalimi i transmetimit të reklamave për një periudhë të shkurtër dhe, së fundi, në pezullimin e licencës për pesë ditë.

Në vitin 2012, organi kombëtar rregullator i transmetimit, Këshilli i Koordinimit Audioviziv (KKA) kreu një proces monitorimi tematik për buletinet e lajmeve të të gjitha kanaleve televizive kombëtare, duke vlerësuar veçanërisht respektimin e kërkesës për paanshmëri. Monitorimi u krye gjatë një periudhe pesëditore dhe metodologjia ishte

hartuar nga KKA-ja në bashkëpunim me ekspertë të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Raporti i monitorimit përmbante një përmbledhje për çdo kanal të të dhënave në lidhje me kohën televizive për çështje që kanë të bëjnë me parti të veçanta politike ose figura të veçanta politike, duke përfshirë numrin e sekondave gjatë të cilave këto çështje janë paraqitur në mënyrë pozitive, negative ose neutrale. Për secilin kanal kjo pasqyrë u shoqërua me një sërë komentesh. Raporti konstatoi se raportimi i kanalit NIT për partinë në pushtet kishte qenë në mënyrë disproporcionale negative, ndërsa raportimi i tij për partitë opozitare kishte qenë kryesisht pozitiv ose neutral. Raporti arriti në përfundimin se NIT kishte shkelur ligjin. NIT-i u ftua në një takim për të diskutuar raportin, pas së cilit KKA-ja votoi për heqjen e licencës së NIT-it. KKA-ja mori parasysh shkeljet e mëparshme të NIT-it, duke theksuar se sanksionet ishin bërë gradualisht më të rënda.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjkata së pari diskutoi parimet bazë mbi pluralizmin e medias dhe rregullimin e transmetimit. Ajo vuri në dukje se çështjet e mëparshme mbi pluralizmin dhe rregullimin e transmetimit kishin të bënin me pluralizmin e jashtëm, ekzistencën e disa mediave që shprehnin këndvështrime të ndryshme, duke çuar në një peizazh mediatik që është pluralist nga një këndvështrim i përgjithshëm, por çështja në fjalë ka të bëjë me pluralizmin e brendshëm, me kërkesën që raportimi i një medie individuale të jetë i balancuar dhe i paanshëm. Për të arritur pluralizmin e vërtetë, të dyja aspektet e pluralizmit mediatik duhet të vlerësohen së bashku. Ajo që kërkohet është diversiteti i përgjithshëm i përmbajtjes së programeve në të gjithë spektrin.

Duke u mbështetur në një vështrim krahasues të rregullimit të transmetimit në të gjithë Evropën, Gjykata konstatoi se ka qasje të ndryshme për arritjen e pluralizmit mediatik. Neni 10 nuk përshkruan një model të caktuar. Për rrjedhojë, shtetet kanë një prag vlerësimi për të vendosur se cilin model të përdorin, për sa kohë që qasja e zgjedhur respekton lirinë editoriale. Kjo do të

thotë se ajo që duhet vlerësuar në këtë çështje ka të bëjë, nga njëra anë, me interesat konkurruese të shoqërisë për ruajtjen e pluralizmit politik në media dhe, nga ana tjetër, me parimin e respektimit të lirisë editoriale. Për të mbrojtur këtë të fundit, është e rëndësishme që të ekzistojnë masa mbrojtëse efektive kundër arbitraritetit dhe abuzimit të pushtetit për rregullimin e medias; kjo do të thotë se duhet të ketë garanci të forta procedurale, veçanërisht kur flitet për vënien e sanksionit ekstrem të tërheqjes së licencës.

Duke vlerësuar kuadrin e përgjithshëm ligjor, Gjykata vërejtë se ai ofronte të gjitha garancitë e nevojshme. Transmetuesit ishin të lirë të vendosnin se si të zbatonin kërkesat e ekuilibrit dhe paanshmërisë (për shembull, legjislacioni nuk kërkonte kohë të barabartë transmetimi për të gjitha partitë politike); dhe legjislacioni ishte hartuar sipas jurisprudencës së mëparshme të Gjykatës ([Manole dhe të tjerët kundër Moldovisë](#), ankimi nr. 13936/02, 17 shtator 2009), e cila i kërkonte shtetit të zbatonte një kuadër për të realizuar pluralizmin në praktikë. Kuadri ligjor ishte në përputhje me atë të vendeve të tjera anëtare të Këshillit të Evropës dhe ishte komentuar nga ekspertë të pavarur të Këshillit të Evropës. Rregullat zbatoheshin jo vetëm për NIT-in, por për të gjithë transmetuesit. KKA-ja ishte një organ i pavarur i specializuar, i cili duhej të arsyetonte çdo vendim për vendosjen e një sanksioni, vendim i cili mund të kundërshtohet para gjykatave.

Në lidhje me vendimin për tërheqjen e licencës, Gjykata vuri në dukje se ky ishte rezultat i një procesi monitorimi pesëditor, i cili kishte ndjekur një metodologji të shëndoshë dhe që ishte mbështetur nga gjykatat e brendshme. Gjetjet e KKA-së kishin qenë të qarta. Gjykata vuri në dukje gjuhën shumë të fortë të përdorur nga NIT-i për të përshkruar qeverinë (duke krahasuar një udhëheqës me «Hitlerin» dhe duke iu referuar të gjithëve me fjalë të tilla si “kriminelë”, “banditë”, “mashtroes”, “servilë” dhe “grup kriminelësh”). Pas shqyrtimit të gjetjeve të KKA-së, Gjykata konstatoi se, përmes raportimit të lajmeve në mënyrën që kishte bërë, NIT-i nuk kishte kontribuar për pluralizmin politik në asnjë mënyrë kuptimplotë. Transmetimet e kundërshtuara, në veçanti emisi-

onet e lajmeve, kishin qenë në gjendje të kishin një ndikim të konsiderueshëm në mbarë vendin.

Licenca e NIT-it u hoq vetëm pasi ishin vendosur një sërë sanksionesh të tjera për shkelje të ngjashme, duke e bërë KKA-në të konsideronte zbatimin e sanksioneve më të rënda. Gjykata nuk gjeti prova për njëanshmëri kundër NIT-it midis anëtarëve të KKA-së, pavarësia e të cilëve ishte e garantuar dhe anëtarët e të cilit ishin emëruar kur partia opozitare kishte qenë në qeveri. Gjykatat e brendshme kishin shqyrtuar vendimin e KKA-së. Për këto arsye, me 14 vota pro dhe 3 kundër, Gjykata konstatoi se heqja e licencës së NIT nuk cenonte të drejtën e saj për lirinë e shprehjes.

Komente të përgjithshme

Kjo është një çështje e rëndësishme (e shënuar si “çështje kyçe” në bazën e të dhënave të Gjykatës) që ngre aspekte themelore të rregullimit të transmetimit dhe pluralizmit të medias. Në kohën e heqjes së licencës së NIT-it, kishte vetëm pesë transmetues televizivë me mbulim kombëtar dhe tregu dominohej nga tre prej tyre. Në një mjedis të tillë transmetimi të përqendruar, garantimi i pluralizmit është thelbësor dhe ligji moldav kërkon që çdo kanal të jetë i paanshëm dhe neutral në transmetimin e lajmeve dhe aktualiteteve. Kjo është ajo që Gjykata në vendimin e saj i referohet si “pluralizëm i brendshëm”, një aspekt të cilin ajo nuk e kishte trajtuar më parë. Megjithatë, për të zbatuar pluralizmin e brendshëm, kufizimet e lirisë editoriale janë të pashmangshme. Për rrjedhojë, duhet të ketë masa mbrojtëse për të parandaluar arbitraritetin dhe abuzimin. Pikërisht në këtë pikë të gjykimit situata ndërlikohet: pyetja për Gjykatën nuk është nëse sanksioni përfundimtar i heqjes së licencës së NIT-it justifikohet me qëllimin e mbrojtjes së pluralizmit mediatik (që justifikohet), por nëse kishte masa mbrojtëse procedurale të mjaftueshme për të siguruar që licenca e NIT-it të mos hiqej në mënyrë arbitrare. Gjykata u shpreh se kishte: kuadri ligjor kombëtar ishte në përputhje me atë të vendeve të tjera evropiane; KKA-ja ishte një organ rregullator i pavarur dhe ekspert; KKA-ja kishte dhënë arsye përkatëse dhe

të mjaftueshme për heqjen e licencës; licenca e NIT-it u revokua pasi ishin aplikuar sanksione më të vogla, por NIT-i kishte “përsëritur shkeljet” dhe shkelja e kushteve të saj të licencës ishte shumë e rëndë; dhe NIT-i kishte mundur të kundërshtonte vendimin e KKA-së para gjykatave kombëtare. Kjo ishte e mjaftueshme për sa i përket drejtësisë procedurale.

Tre gjyqtarët me opinion ndryshe nuk janë kundër parimeve që vendos Gjykata, por nuk pajtohen me mënyrën se si gjykata i zbaton ato. Për

rrjedhojë, në nivelin e parimeve, ky vendim i Dhomës së Madhe të Gjykatës përbën një precedent të rëndësishëm. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian është mbështetur në këtë vendim për të hedhur poshtë pretendimin e kanalit *Russia Today* në Francë kundër tërheqjes së licencës së tij ([RT France kundër Këshillit](#), ankimi T-125/22, 27 korrik 2022).

Liria e shprehjes dhe liria e mediave në Evropën Juglindore (JUFREX)

Projekti është i pjesë e "Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022" dhe bazohet në rezultatet e arritura gjatë programit të mëparshëm të bashkuar rajonal të BE/KE "Përforsimi i Ekspertizës Gjyqësore mbi Lirinë e Shprehjes dhe Medias në Evropën Juglindore (JUFREX)". Veprimi rajonal është i ndërlidhur fuqishëm me gjashtë veprimet JUFREX që janë specifike për Përfituesin në: Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kosovë*, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi.

Aktivitetet e JUFREX implementohen me synim që të:

- "Promovojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në përputhje me standardet evropiane;
- "Përmirësojnë zbatimin e atyre standardeve duke angazhuar një sërë aktorësh përgjegjës për të aplikuar standarde të tilla në punën e tyre të përditshme, përkatësisht: gjyqtarë, prokurorë, avokatë, oficerë policie, përfaqësues të autoriteteve rregullatore të mediave, aktorë të medias dhe studentë;
- "Konsolidojnë një platformë për bashkëpunim, diskutim dhe shkëmbim rajonal të praktikave të mira.

Kur ekziston një mjedis favorizues për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias dhe e drejta për të kërkuar, dhënë dhe marrë informacion është e mbrojtur mirë, qytetarët mund të marrin pjesë vërtet në proceset demokratike. Institucionet kombëtare të trajnimit për profesionistët ligjorë (Akademitë Gjyqësore dhe Dhoma e Avokatëve) luajnë rol kryesor për ta bërë këtë realitet.

Të gjitha aktivitetet e JUFREX bazohen në mjete inovative dhe moderne të mësimnxënies për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias dhe përvetësojnë një metodologji dinamike për mësimnxënie nga të rriturit dhe një model kokë-më-kokë.

"Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022" është një iniciativë e bashkuar e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës që u mundëson Përfituesve t'i përmbushin agjendat e tyre të reformave në fushat e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë dhe të jenë në përputhje me standardet evropiane, përfshirë aty ku është e nevojshme brenda kornizës së procesit të zgjerimit të BE-së.

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

* Ky përkufizim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve për statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e të drejtave të njeriut në kontinent. Ai përfshinë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i krijuar për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën që gradualisht ta lidhin dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku ata ndërtuan një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke ruajtur larminë kulturore, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian i zotohet bashkëndarjes së arritjeve dhe vlerave të tij me shtetet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës